

Vendi i ambasadës "varet" nga Izraeli



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE I KOSOVËS U KA BËRË THIRRJE QYTETARËVE QË T'I RESPEKTOJNË MASAT PËR FAKTIN SE KA TENDENCË TË RRIJTJES SË RASTEVE ME COVID

SHTOHEN RASTET ME COVID, KOSOVA ENDE PA VAKSINË

FAQE 4-5

Në 24 orët e fundit kanë humbur jetën nëntë pacientë të infektuar me Covid-19, ndërkaq janë konfirmuar edhe 467 raste të reja me Covid. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), kjo shifër paraqet numrin më të madh të rasteve pozitive këtë vit, "me tendencë të rritjes në ditët në vijim". IKShPK-ja ka theksuar se numri i rasteve pozitive dhe vdekjeve nga Covidi vazhdon të jetë i lartë dhe brengosës si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave. Kosova është vendi i vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nuk ka nisur ende vaksinimin e njerëzve kundër Covid-19



AKTUALE



TRUMPI JEP SHENJA PËR GARË PRESIDENCIALE NË VITIN 2024 F. 5

PD-JA DHE LSI-ja NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJEN PËR KOALICION F. 5

KLINIKA E NEUROLOGJISË OFRON SHËRBIME TË REJA MJEKËSORE F. 6

EKONOMI



EVAZIONI FISKAL, DERI NË 30 PËR QIND F. 9

DREJTORËT E KOMPANIVE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE KËRKOJNË MBËSHETJE FINANCIARE F. 9

SPORT

DREJTUESIT E FFK-SË TAKOHEN ME PËRZGJEDHËSIN NEES F. 13

NUMËROHEN MBI 13 000 VOTA ME KUSHT, LV-ja PRIN ME 6 747 VOTA

Deri të hënën pasdite janë numëruar më tepër se gjysma e votave me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta. Sipas të dhënave të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, Lëvizja Vetëvendosje (LV) prin me 6 747 vota, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 2 373 vota dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 1 473. Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije se



pas përfundimit të numërimit të këtyre fletëvotimeve, do të fillojë numërimi i votave nga jashtë vendit

FILLON PROCESI I DEKLARIMIT TË PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIKË

FAQE 8



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi jep shenja për garë presidenciale në vitin 2024

WASHINGTON, 1 MARS - Ish-presidenti amerikan Donald Trump i është kthyer skenës politike më 28 shkurt, për herë të parë prej kur është larguar nga zyra, duke bërë përpjekje për ta fuqizuar pozitën e tij si lider i nevojshëm i Partisë Republikane.

Në fjalimin e tij të parë të madh, nga koha kur Joe Biden ka nisur udhëheqjen e Shteteve të Bashkuara në janar, Trumpi ka dhënë shenja për garë të mundshme për president më 2024 dhe ka hedhur poshtë thashethemet se planifikon të formojë një parti të tretë. "Unë do të vazhdoj të luftoj në anën tuaj. Ne nuk do të krijojmë parti të reja", ka thënë Trumpi në një fjalim në Konferencën Politike Konservatore në Orlando, Florida. "Ne kemi Partinë Republikane. Do të jetë e fuqishme dhe e bashkuar si kurrë më parë", ka shtuar ai.

Trumpi ka vazhduar ta hedhë poshtë humbjen e tij në zgjedhjet e 3 nëntorit dhe ka kritikuar Bidenin për një varg çështjesh, duke thënë se shteti është kthyer nga "Amerika e para në Amerika e fundit". "Joe Bideni ka pasur muajin e parë më shkatërrues sesa secili president i historisë moderne", ka thënë Trump.

Për dallim nga disa ish-presidentët e tjerë, Trump e ka bërë të qartë se nuk ka qëllim që

të largohet nga skena politike apo t'i ndalë kritikën për pasardhësin e tij.

Shtëpia e Bardhë ka thënë se nuk do t'iu kushtojë shumë vëmendje deklaratave të Trumpit. "Fokusi ynë nuk është ai se çfarë është duke thënë presidenti Trump", në Konferencën Politike Konservatore, ka thënë zëdhënësjja e Shtëpisë së Bardhë, Jen Psaki, para gazetarëve javën e kaluar. Javët e fundit të Trumpit në zyrë janë përcjellë me kundërshtim të rezultatit zgjedhor dhe trazira në ndërtesën e Kongresit nga mbështetësit e tij, të cilët kanë sulmuar këtë institucion, duke thëlluar ndasitë partiake. Ai është paditur për nxitje të kryengritjes në Kongres, mirëpo është shfajësuar nga Senati.

Trump vazhdon të jetë popullor në mesin e mbështetësve republikanë, mirëpo roli i tij i ardhshëm në parti është i diskutueshëm.

Figura sikurse lideri i pakicës në Senat, Mitch McConnell dhe republikanja numër tre në Dhomën e Përfaqësuesve, Liz Cheney, janë të etur për ta zvogëluar ndikimin e ish-presidentit në parti. Mirëpo Trump ka shfrytëzuar fjalimin e tij për ta paraqitur veten si e ardhmja e Partisë Republikane, pavarësisht pse republikanët kanë humbur jo vetëm



Shtëpinë e Bardhë, por edhe të dyja dhomat e Kongresit në zgjedhjet e kaluara.

Në një sondazh joformal të zhvilluar në konferencën me mbi 1 000 pjesëmarrës, ka dalë se 97 për qind e respondentëve e përkrahin punën që ka bërë Trump si president.

Rreth 68 për qind e kanë përkrahur Trumpin për garë më 2024, derisa 32 për qind e të anketuarve kanë kundërshtuar

një gjë të tillë apo nuk kanë pasur mendim për këtë çështje. Në pyetjen nëse gara për zgjedhjet e vitit 2024 do të ishte në garë, 55 për qind e respondentëve kanë thënë se do të votonin për të, derisa 21 për qind kanë përkrahur guvernatorin nga Florida, Ron DeSantis.

Ndonëse është ende herët, ambicia e Trumpit për të

garuar edhe një herë tjetër për pozitë të presidentit, mund t'ua kufizojë kandidatëve të tjerë gatishmërinë për t'u përgatitur për garën e vitit 2024.

Në klubin e tij Mar-a-Lago në Florida, Trump ka ndërtuar bazën për operacionet e tij politike pas presidencës dhe është duke gjetur kandidatë për Kongres që pasqyrojnë politikën e tij.

Së paku tre muaj kohë për 'Covid-pasaportat'

BRUKSEL, 1 MARS - Komisioni Evropian ka paralajmëruar se gjatë muajt mars do ta miratojë propozimin legjislativ për atë që tashmë është emërtuar si "Covid-pasaportë", e që në BE e quajnë "certifikatë e vaksinimit" kundër koronavirusit.

Zëdhënësi i Komisionit Evropian, Eric Mamer, ka pohuar se për ta filluar zbatimin në praktikë të këtyre vërtetimeve për vaksinim, do të duhen së paku tre muaj.

Ideja është që personat e vaksinuar do të kenë një "certifikatë të vaksinimit" në formën elektronike dhe kjo do t'ua lehtësojë udhëtimet.

BE-ja deri tash ka këmbëngulur se fjala është për "certifikatë" që do të përdoren vetëm për "çështje shëndetësore", e jo si "dokumente udhëtimi". Megjithatë, Komisioni Evropian tani pranon se qëllimi është të lehtësohet udhëtimi në kohën kur po bëhen përpjekje për rimëkëmbje ekonomike, sidomos në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit.

Mamer, i pyetur se a do të jenë këto vërtetime për vaksinim vetëm për përdorime në sistemin shëndetësor apo edhe për udhëtime, tha se ato "në bazë të gjendjes shëndetësore do ta lehtësojnë udhëtimin".

Komisioni Evropian,



megjithatë, nuk ka fuqi të vendosë për këtë çështje, por vetëm të propozojë. Pastaj, vendet anëtare, së bashku apo secila në mënyrë individuale, mund të vendosin se si t'i përdorin këto vërtetime.

Kjo ishte ndër temat kryesore të samitit të liderëve të BE-së në fund të javës së shkuar, ndërsa tani Komisioni Evropian ka filluar punën për ta nxjerrë propozimin e hollësishëm. Kjo ide vazhdon të krijojë ndasi

brenda Bashkimit Evropian, për shkak se zbatimi i saj mund të shkaktojë diskriminim, i cili nuk është i lejueshëm sipas ligjeve të BE-së. Kundërshtuesit e kësaj ideje thonë se mungesa e vaksinave, që u pamundëson të gjithë qytetarëve që duan të vaksinohen, ta bëjnë një gjë të tillë, është një arsye shtesë për të mos nxituar me këtë ide.

Por, në anën tjetër, vendet turistike si Greqia, Spanja, Kroacia dhe Malta duan që sa më parë të lehtësohet udhëtimi sepse, siç thonë, një sezon sadopak normal turistik është i domosdoshëm për rimëkëmbjen e ekonomive të tyre.

'Shqipëria përmbushi kushtet për hapjen e negociatave me BE-në'

Bruksel, 1 mars - Në mbledhjen e njëmbëdhjetë të Këshillit të Stabilizim Asocimit BE - Shqipëri, ndryshe nga herët e kaluara

me përfaqësim në rang ministri, kryeministri Edi Rama ka zgjedhur të shkojë vetë. "Top Channel" ka mësuar se gjatë diskutimeve

në këtë këshill, Josep Borell, zëvendëspresident i Komisionit Evropian dhe komisionari për zgjerim, Oliver Varhelyi, janë shprehur

se praktikisht Shqipëria i ka përmbushur të gjitha kushtet dhe se tani do të duhet të hapet konferenca ndërqeveritare.



Numërimi i votave me kusht dhe tëpersonave me nevoja të veçanta, drejt përfundimit

Numërohen mbi 13 000 vota me kusht, LV-ja prin me 6 747 vota

Deri të hënën pasdite janë numëruar më tepër se gjysma e votave me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta. Sipas të dhënave të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, Lëvizja Vetëvendosje (LV) prin me 6 747 vota, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 2 373 vota dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 1 473. Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije se pas përfundimit të numërimit të këtyre fletëvotimeve, do të fillojë numërimi i votave nga jashtë vendit



(votim grupor); 910 zarfe të dërguara nga votues të cilët kanë bashkangjitur dokumente jovalide për identifikim; 1 656 zarfe me fletëvotime jashtë rrethit të

ngushtë familjar. Pra, brenda një pakoje/dërgese kanë qenë nga 84, 39, apo 37 zarfe të individualizuara me fletëvotime jashtë rrethit të ngushtë familjar; dhe 385 pako

me fletëvotime që janë dorëzuar personalisht në postën numër 6 në Kosovë dhe nuk përmbajnë vulën dhe as pullën postare të postës dërguese”, ka thënë Elezi.

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 1 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se deri të hënën pasdite janë numëruar mbi 13 570 vota me kusht dhe të personave me aftësi të kufizuara. Sipas të dhënave zyrtare, Lëvizja Vetëvendosje deri tani ka 6 747 vota, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës me 2 373 vota. Pas tyre renditet Lidhja Demokratike e Kosovës me 1 473 vota dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 1 301 vota. “Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është duke vazhduar numërimi i votave me kusht dhe votave të personave me nevoja të veçanta. Menjëherë pas tyre do ta fillojmë numërimin e votave nga jashtë Kosovës. Sipas të dhënave, janë rreth 32 mijë fletëvotime të konfirmuara me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta të cilat janë pjesë e procesit të numërimit. Deri më tani janë numëruar më shumë se gjysma e tyre”, ka thënë zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një konferencë

për media.

Pas përfundimit të numërimit të këtyre fletëvotimeve, ai ka treguar se do të fillohet numërimi i votave nga jashtë vendit, të cilat kanë ardhur gjatë periudhës së votimit përmes postës nga 2 deri më 12 shkurt. “Tashmë shërbimi votues i KQZ-së ka përmbyllur vlerësimin dhe verifikimin e pakove të supozuara me fletëvotime. Nga numri total i pakove të proceduara, pas procesit të vlerësimit janë aprovuar 56 610 zarfe me fletëvotime dhe janë refuzuar 22 591 zarfe me fletëvotime”, është shprehur ai. Sipas Elezit, arsyet e refuzimit janë të ndryshme dhe janë të kategorizuara në shtatë grupe kryesore. “9 199 zarfe janë dërguar nga persona që nuk janë të regjistruar si votues jashtë Kosovës; 6 665 zarfe janë dërguar nga persona që nuk kanë arritur të regjistrohen si votues jashtë Kosovës gjatë periudhës së aplikimit sepse nuk kanë dëshmuar kriteret ligjore; 1 325 votues kanë dërguar fletëvotime nga dy herë; 2 451 zarfe të dërguara nga votues të pidentifikuar

Kurti: Ka tendenca që fitorja jonë të zvogëlohet

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka folur në lidhje me procesin e numërimit të votave të diasporës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ai ka thënë se janë duke e përcjellë me vëmendje procesin e

numërimit të votave të diasporës. Sipas Kurtit, refuzimi i mbi 22 mijë zarfeve nga diaspora tregon për tendencën që fitorja e LV-së të zvogëlohet. “Ne po e përcjellim me vëmendje dhe qartazi ka tendenca që fitorja

jonë plebishitare sadopak të zvogëlohet. Edhe vonesa edhe këto padrejtësi të vogla në dukje teknike, por që s’janë të tilla, nuk mund ta ndalin fitoren e madhe që ka arritur LV-ja në zgjedhjet e fundit”, ka deklaruar Kurti.

Hoxhaj takon ambasadorin Abbott: PDK-ja pret konstituimin e shpejtë të institucioneve

PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, i shoqëruar nga anëtari i kryesisë, Muzafer Shala, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott. Gjatë këtij takimi është diskutuar për gjendjen e krijuar nga pandemia Covid-19, ku është shprehur shqetësimi për vonesën për sigurimin e vaksinës anti-Covid për popullatën dhe ndikimin që ka pasur pandemia në ekonominë e vendit. Hoxhaj dhe Abbott kanë folur

edhe për situatën aktuale politike në vend, pas përfundimit të zgjedhjeve të 14 shkurtit. Hoxhaj ka theksuar se është e nevojshme që sa më parë të konstituohet Kuvendi dhe të formohet qeveria e re. Ai ka falënderuar ambasadorin britanez për mbështetjen dhënë Kosovës gjatë kësaj periudhe dhe ka thënë se vendit i duhet edhe më tej përkrahja nga partnerët ndërkombëtarë në aspektin e konsolidimit të brendshëm dhe të jashtëm, për rimëkëmbjen ekonomike dhe për çështjet e sigurisë dhe sundimit të ligjit.





INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE I KOSOVËS U KA BËRË THIRRJE QYTETARËVE QË T'I RESPEKTOJNË MASAT PËR FAKTIN SE KA TENDENCË TË RRIJTJES SË RASTEVE ME COVID

Shtohen rastet me Covid, Kosova ende pa vaksinë

Në 24 orët e fundit kanë humbur jetën nëntë pacientë të infektuar me Covid-19, ndërkaq janë konfirmuar edhe 467 raste të reja me Covid. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), kjo shifër paraqet numrin më të madh të rasteve pozitive këtë vit, “me tendencë të rritjes në ditët në vijim”. IKShPK-ja ka theksuar se numri i rasteve pozitive dhe vdekjeve nga Covidi vazhdon të jetë i lartë dhe brengosës si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave. Kosova është vendi i vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nuk ka nisur ende vaksinimin kundër Covid-19

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 MARS - Nëntë viktimat dhe 467 raste të reja me Covid-19 u raportuan të hënën në Kosovë. Sipas raportit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), dy raste të vdekjes u regjistruan në Pejë, dy në Prishtinë dhe nga një rast në Deçan, Gjakovë, Kaçanik, Prizren dhe Rahovec. Rastet e reja pozitive, ndërkaq, rezultuan pas testimit të 2 914 mostrave. Sipas IKShPK-së, shifra paraqet numrin më të madh të rasteve pozitive këtë vit, “me tendencë të rritjes në

ditët në vijim”.

Po sipas raportit, 214 pacientë u konfirmuan si të shëruar në 24-orëshin paraprak.

Me këto shifra numri i përgjithshëm i të infektuarve me Covid në Kosovë arrin në 69 697, i viktimave në 1 608 dhe i të shëruarve në 60 063.

Raste aktive me Covid aktualisht janë 8 026.

Kosova është vendi i vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nuk ka nisur ende vaksinimin kundër Covid-19.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka theksuar se numri i rasteve pozitive dhe vdekjeve nga Covid-19 vazhdon të jetë i lartë

dhe brengosës si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave. “Mjekët të stërngarkuar në spitale po luftojnë kundër këtij virusi tinëzar e shkatërrimtar me tërë fuqinë e tyre profesionale e njerëzore. IKShPK-ja përsërit thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19. Masat parandaluese janë të njëjta, me aksent të veçantë se personat pozitivë duhet të qëndrojnë në shtëpi për ta parandaluar përhapjen në familje dhe në komunitet. Me zvogëlimin e kontakteve do ta bëjmë të mundur ndërprerjen e përhapjes së infeksionit”, është

PD-ja dhe LSI-ja nënshkruajnë marrëveshjen për koalicion

TIRANË, 1 MARS - Edhe pse në garën zgjedhore të 25 prillit do të hyjnë në lista të veçanta, Partia Demokratike (PD) dhe Lëvizja Socialiste për Integritim (LSI) do të jenë në një koalicion të përbashkët pas zgjedhjeve. Dy partitë më të mëdha të opozitës kanë firmosur këtë të hënë marrëveshjen për koalicionin

në zgjedhjet e përgjithshme që do të zhvillohen pas 56 ditësh. Sipas marrëveshjes, dy forcat më të mëdha të opozitës angazhohen të nxjerrin vendin nga kriza ekonomike, t'i përmbushin kushtet për hapjen e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. “Rivendosja e shtetit të së drejtës dhe e sundimit të

ligjit, frenim shpopullimit, punësim i mirëpaguar, luftë pa kompromis kundër krimit të organizuar, zgjidhje në mënyrë prioritetë problemin e rindërtimit të banesave të dëmtuara dhe dhënien fund problemit kritik të pandemisë Covid-19”, thuhet se janë disa prej angazhimeve të PD-së dhe LSI-së.



thënë në apelin e këtij instituti. IKShPK-ja ka rekomanduar që të qëndrohet në shtëpi dhe dalja të jetë vetëm për nevoja të domosdoshme, po ashtu ka rekomanduar që të mos ketë kontakte me njerëz me të cilët nuk jetoni në bashkësi, pos për qëllime specifike. “Ndalimi rigoroz i tubimeve; Respektimi rigoroz i masave kufizuese në aktivitetet publike; Kufizimi i punës për veprimtaritë joesenciale dhe vendngjarjet duke reduktuar edhe kohën e punës gjatë ditës”, është theksuar në rekomandimet e IKShPK-së.

IKShPK-ja ka vlerësuar se këto masa mund ta ndalin rritjen e numrit të rasteve, mund ta parandalojnë mbingarkesën e hospitalizimeve dhe ta parandalojnë rritjen e numrit të vdekjeve. “IKShPK-ja apelon te të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat publike dhe private, për respektimin dhe ndërmarrjen e të gjitha masave

të nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e infeksionit Covid-19, duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, dhe vendimet në fuqi mbi masat dhe obligimet e institucioneve për zbatimin e masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19. Në veçanti, bëjmë thirrje për zbatimin e rekomandimeve dhe respektimin e masave kufizuese për aktivitetet publike, përkatësisht kufizimeve për grumbullimin e qytetarëve dhe tubimeve publike”, është thënë në apelin e IKShPK-së.

Ky institut ka theksuar se grumbullimi i qytetarëve pa maska dhe pa mbajtje të distancës shton rrezikun e përhapjes së infeksionit përdërisa virusi është i pranishëm në mesin tonë. “Apelojmë tek institucionet përgjegjëse, përkatësisht

Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse, që t'i mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave dhe vendimeve të tjera në fuqi në zbatim të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në Republikën e Kosovës”, është thënë në njoftimin e IKShPK-së. Muaji shkurt, ishte thënë në vazhdimësi nga kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti dhe ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, se do të jetë muaji kur vaksina do të arrijë në Kosovë, por kjo ende nuk ka ndodhur.

Ministria e Shëndetësisë e Kosovës përmes një komunikate për media ka bërë publike disa informacione të cilat kanë të bëjnë lidhur me angazhimet për sigurimin e vaksinës kundër Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se ka kryer të gjitha

Rastet e fundit pozitive në komunat e Kosovës

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 188 raste, Pejë 42 raste, Ferizaj 29 raste, Podujevë 25 raste, Prizren 24 raste, Gjakovë 21 raste, Mitrovicë 20 raste, Fushë-Kosovë 16 raste, Gjilan 16 raste, Suharekë 13 raste, Lipjan 10 raste,

Kamenicë 8 raste, Kaçanik 8 raste, Viti 8 raste, Vushtrri 8 raste, Shtime 6 raste, Drenas 5 raste, Istog 5 raste, Rahovec 4 raste, Deçan 3 raste, Klinë 3 raste, Dragash 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Obiliq dhe Skenderaj.

kriteret e kërkuara për sigurimin e vaksinave, dhe se është duke pritur konfirmimin final nga COVAX për arritjen e dozave të para. “MSh-ja i siguron qytetarët se ky angazhim do të jetë maksimal, përtej çdo interesi, për përmbushje të obligimit për të siguruar shëndetin e qytetarëve, deri në pranimin e dozave të

para që besojmë se do të ndodhë së shpejti dhe për përmbylljen e programit të vaksinimit kundër Covid-19”, thuhet në sqarimin e MSh-së.

Kosova pritet të marrë nga COVAX-i 100 800 doza të vaksinës së prodhuar nga kompania britanike “AstraZeneca” dhe Universiteti i Oksfordit.



Shqipëria do të pranojë mbi 15 mijë doza të “Pfizer”-it

Tiranë, 1 mars - Autoritetet në Shqipëri kanë njoftuar se do të pranojnë edhe 15 210 doza të vaksinës kundër Covid-19, të kompanisë amerikane “Pfizer”. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Orgeta Manastirliu, ka thënë se me këtë kontingjent të ri do të përfundojë vaksinimi i stafit

mjekësor dhe do të vazhdojë vaksinimi i personave mbi 80 vjeç. “Brenda dy javëve të para të marsit pritet të mbërrijnë edhe 14 400 vaksina të ‘AstraZenecas’, me të cilat do ta vijojmë vaksinimin, duke pasur prioritet mësuesit”, ka deklaruar Manastirliu. Shqipëria, pothuajse në baza

javore, po pranon kontingjente të dozave të vaksinës të “Pfizer”-it. Deri më tani Tirana zyrtare ka pranuar 17 355 doza të vaksinës së “Pfizer”-it. Fushata e vaksinimit në Shqipëri nisi më 11 janar. Në bazë të kontratës së nënshkruar me kompaninë “Pfizer”, Shqipëria pritet të

marrë mbi 500 mijë doza të vaksinës. Gjatë muajit shkurt, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, kishte njoftuar se nga kompania farmaceutike britanike “AstraZeneca” pritet të marrin në total 360 000 doza të vaksinës, të dhuruara “nga një shtet mik”, por pa treguar se nga cili shtet do të merren këto doza.



LV-ja kritikon raportimet për shfuqizim të fletarrestimit për Radoiçiqin

PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka reaguar të hënën pas raportimeve të mediave në Kosovë se Gjykata Themelore në Prishtinë ka miratuar kërkesën e Prokurorisë Speciale për të shfuqizuar fletarrestimin për nënkryetarin e Listës Serbe, Millan Radoiçiq. "Kujtojmë se Milan Radoiçiqi, të cilit gjykata ia hoqi fletarrestimin, për gjithë këto vite sfidon ligjin, por edhe sovranitetin e integritetin e Republikës së Kosovës. Me veprimtarinë e tij kriminale, sidomos në veri të vendit, ai ka qenë gjithnjë pengesë e jetës normale duke terrorizuar të gjithë qytetarët e të gjitha komuniteteve pa dallim", është thënë në reagimin e LV-së.

Aty është përmendur edhe se Radoiçiq është një nga të dyshuarit kryesor për vrasjen

e politikanit serb të Kosovës, Oliver Ivanoviq. Milan Radoiçiq ka qenë në arrati dhe autoritetet e Kosovës deri më tani ishin në kërkim të tij. Në nëntor të vitit 2020 është ngritur aktakuza e tretë për këtë rast, mirëpo procesi gjyqësor është ende pa epilog.

Ivanoviq është vrarë më 16 janar 2018, me gjashtë të shtëna në shpinë, përpara objektit të partisë së tij në Mitrovicën e Veriut.

Lëvizja Vetëvendosje ka thënë se Prokuroria Speciale dhe Gjykata Themelore duhet t'ia sqarojnë publikut të Kosovës vendimin lidhur me këtë rast. "Kushdo këtë veprim të papritur e sheh me dyshim dhe si larje të borxheve të mëhershme apo kusht për aleancat e reja të nëntokës e parapolitikës. Sipas saj, një vendim i tillë përbën rrezik e



të panjohura. Kjo parti, fituese e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit në Kosovë,

është zotuar edhe një herë që kur ta marrë pushtetin do ta nisë procesin e vetingut në gjyqësi dhe prokurori, duke

konsideruar se shtetit i duhen profesionistë dhe patriotë dhe jo "burokratë në shërbim të kriminimit".

Klinika e Neurologjisë ofron shërbime të reja mjekësore

EPOKA E FATON DËRMAKU

Prishtinë, 1 mars - Ndonëse e ngarkuar me trajtimin e personave të prekur me Covid-19, në një pjesë të konsiderueshme të vitit 2020, Klinika e Neurologjisë në QKUK ka arritur me sukses të aktivizojë hapësira dhe shërbime të reja, shumë të rëndësishme për trajtimin e



pacientëve me probleme shëndetësore neurologjike. Është funksionalizuar reparti

për trajtimin e pacientëve jashtëspitalor, ambulanca emergjente, hapësira për

trajtimin e aksidentit akut iskemit trunor me trombolizë dhe qendra për strok. Janë funksionalizuar ambulancat specialistike, neurofiziolgjike, neuropsikologjike, hapësirat për trajtimin e pacientëve me Sklerozën Multiple dhe ka filluar projekti nacional për SM, me të cilin të gjithë pacientët mbuloohen me terapi imunomoduluese. Gjithashtu, është trajnuar stafi

dhe janë përpiluar protokollet për sëmundjen iskemike trunore, epilepsi dhe Skleroze Multiple. Vitin e kaluar në Klinikën e Neurologjisë janë kryer 6 mijë e 252 vizita ambulatorë, 1 mijë e 603 ekzaminime EEG, 819 ekzaminime EMNG, 659 ekzaminime Doppler, derisa janë ofruar 1 mijë e 422 shërbime në Kabinetin e Sëmundjeve Demilinizuese.

Protestojnë pjesëtarët e Shërbimit Korrektues, kërkojnë paga shtesë gjatë pandemisë

Prishtinë, 1 mars (ER) - Sindikata e Shërbimit Korrektues ka protestuar të hënën para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. Kjo protestë është mbajtur lidhur me shtesat për punë gjatë pandemisë ashtu siç i kanë realizuar institucionet e tjera të sigurisë. "Stafi i ShKK-së është në vijën e parë të luftimit të pandemisë Covid-19 dhe i plotëson të gjitha kriteret e parapara me ligj në bazë të nenit 20, pika 1 dhe 2, ku përcaktohet kompensimi dhe në bazë të nenit 12, pika 1.4,

izolimi, pika 1.5, transporti, pika 1.7, trajtimi dhe shërimi i të sëmurëve me Covid-19 dhe pika 1.9, mbikëqyrja shëndetësore e personave të infektuar me Covid-19", është thënë në njoftimin e këtij institucioni.

Përfaqësuesit e Sindikatës së Pavarur të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pas takimit me kryeministrin në detyrë, Avdullah Hoti, kanë pezulluar protestën. Hoti ka premtuar realizimin e kërkesave të tyre dhe se shtesat do t'u jepen gjatë muajit mars.



Mësimdhënësit marrin shtesat prej 100 eurosh

PRISHTINË, 1 MARS - Mësimdhënësit e Kosovës për muajin shkurt kanë marrë 100 euro shtesë të parapara

nga marrëveshja me qeverinë Hoti. Lajmin e ka konfirmuar Ymer Ymeri nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit dhe

Shkençës. "Mësimdhënësit për muajin shkurt i kanë marrë nga 100 euro shtesë, ashtu siç ka qenë e

planifikuar nga marrëveshja me qeverinë Hoti", ka konfirmuar Ymeri. Sipas tij, presin që edhe për muajin mars të paguhet kjo shtesë.



Vendi i ambasadës 'varet' nga Izraeli

PRISHTINË, 1 MARS - Kreu i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka paralajmëruar se do ta shqyrtojë çështjen se në cilin qytet, Tel Aviv apo Jerusalem, do të vendoset Ambasada e Kosovës në Izrael, duke thënë se për këtë gjë do ta shohin "edhe dokumentacionin e qeverisë në ikje".

Sipas një njoftimi të Vetëvendosjes, këtë deklaratë Kurti e bëri më 1 mars, gjatë takimit me ambasadorin turk në Prishtinë, Çagri Sakar. Megjithatë, Kurti ka thënë se vendosja e marrëdhënieve diplomatike në mes të Kosovës dhe Izraelit është e rëndësishme dhe "mundësi e mirë për zhvillim".

Por, sipas të drejtës diplomatike dhe konsullore, në kuadër të standardit të së drejtës ndërkombëtare publike, përcaktimi i lokacioneve të përfaqësive të huaja diplomatike, është e drejtë ekskluzive kushtetuese dhe sovraane e shtetit që i pranon ato përfaqësi, thotë Enver Hasani, profesor i të drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës. Sipas tij, në këtë rast as Kosova, si vend që pritet ta dërgojë përfaqësinë diplomatike në Izrael, nuk e ka të drejtën për ta përcaktuar lokacionin apo vendndodhjen e përfaqësive të saj diplomatike në këtë vend.

Lëvizja Vetëvendosje, si fituese e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit në Kosovë, në bazë të rezultateve paraprake të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ende nuk është deklaruar nëse do ta hapë Ambasadën e Kosovës në Jerusalem, pasi ta formojë qeverinë e re të vendit.

Më 4 shtator 2020 Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë në Uashington, dy dokumente për normalizimin e raporteve ekonomike, në prani të presidentit të atëhershëm amerikan, Donald Trump. Dokumenti i nënshkruar nga Kosova, parasheh njohjen e ndërsjellë me Izraelin. Ndërkaq, në rastin e Serbisë, zhvendosjen e ambasadës së saj nga Tel Avivi në Jerusalem, gjë që ende nuk ka ndodhur.

Qeveria në detyrë e Avdullah Hotit kishte deklaruar se do ta hapë Ambasadën e Kosovës në Jerusalem.

Më 1 shkurt Kosova dhe Izraeli, në një ceremoni virtuale, formalizuan vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Ministri i Punëve të Jashtme të Izraelit, Gabriel Ashkenazi, atë ditë ka deklaruar se ka miratuar



kërkesën e ministres në detyrë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla, që Kosova ta hapë ambasadën në Jerusalem. Bashkimi Evropian, më 2 shkurt të vitit 2021, ka shprehur keqardhje për vendimin e Kosovës që të hapë ambasadën e saj në Jerusalem, qytet të cilin BE-ja e konsideron me status të pazgjidhur.

Por, Antony Blinken, sekretar amerikan i Shtetit, më 19 janar, para se ta merrte detyrën aktuale, pati deklaruar që e duartrokoi "punën që është bërë për Kosovën dhe Serbinë", nga administrata e presidentit Donald Trump.

Hasani: Lokacionin për ambasadë e cakton pala mikpritëse

Profesori i të drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Enver Hasani, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se në raportet Kosovë dhe Izrael ka pasur dy akte. E para, sipas tij, më 4 shtator në Uashington, Kosova ka nënshkruar zotimin, që paraqet njohjen ndërmjet dy shteteve, Kosovës dhe Izraelit dhe akti i dytë, siç thotë ai, është themelimi i marrëdhënieve diplomatike në aspektin formal ndërmjet dy shteteve. "Në marrëveshje për themelimin e marrëdhënieve diplomatike, palët nuk mund t'i diktojnë njëra-tjetrës lokacionet se ku mund të jenë ambasadat, përkatësisht, përfaqësitë diplomatike dhe konsullore për shkak se atë e përcakton shteti i pranimit, shteti mikpritës, në

këtë rast Izraeli. Çdo shmangie nga ky rregull nënkupton devijim të politikës bilaterale me Izraelin dhe orientim të Kosovës me vendet e Lindjes së Mesme që kanë orientim islamik", ka theksuar Hasani.

Kurti ndërmjet "dy zjarreve"

Pas fitores së Lëvizjes Vetëvendosje në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit në Kosovë, Albin Kurti, i cili është kandidat për kryeministër të vendit, ka marrë letra urimi nga kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu dhe nga presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan.

Përderisa Netanyahu i ka shkruar Kurtit se e mirëpret në Izrael "për të inauguruar Ambasadën e Republikës së Kosovës në Jerusalem", në anën tjetër Erdogani e ka porositur Kurtin që "do të ishte e dobishme që të shmangej një hap të tillë, i cili mund t'i shkaktonte dëme të mëdha Kosovës".

Izraeli e ka njohur Kosovën pas nënshkrimit të palës së Kosovës të dokumentit me zotime, më 4 shtator në Uashington. Kosova dhe Serbia, sipas zotimeve të nënshkruara në Shtëpinë e Bardhë, ambasadat e tyre duhet t'i hapin në Jerusalem. Përderisa Kosova ende nuk ka përfaqësi diplomatike në Izrael, Serbia e ka ambasadën e saj në Tel Aviv.

Kalkulime politike?

Zyrtarë nga partia e Kurtit kanë thënë se për çështjen se a do ta

hapë Kosova ambasadën e saj në Jerusalem, do të deklarohen pasi të formohet qeveria. Për më shumë lidhur me këtë çështje, ata kanë udhëzuar që t'u referohemi deklaratave të Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit të cilat i kanë dhënë më 12 shkurt, në një nga televizionet vendore. Vjosa Osmani, e cila nga Lëvizja Vetëvendosje është propozuar si kandidatë për presidente të Kosovës, nuk ka precizuar nëse Kosova do ta hapë Ambasadën në Jerusalem. "Në fakt, marrëveshja, në pikën e saj të fundit, thotë që Kosova (Prishtina) dhe Izraeli pajtohen që të bëjnë njohje reciproke. Askund nuk përmendet Jerusalem... Ajo çfarë do të ketë rëndësi për ne do të jetë qëndrimi i administratës së re (të ShBA-së), qëndrimi i administratës Biden", ka theksuar Osmani.

Pas kësaj deklaratë të Osmanit, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, kishte folur shkurt. "Unë nuk kam çfarë i shtoj deklaratimit të presidentes (së propozuar nga Vetëvendosje)", ka theksuar Kurti më 12 shkurt. Por, profesori Hasani shpreh mendimin që deklaratat e zyrtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje, përmes të cilave nuk jepet një përgjigje e saktë nëse Kosova do ta hapë Ambasadën në Jerusalem, më tepër është kalkulim për politikën e brendshme. "Unë besoj se është kalkulim politik, që bëhet për galeritë politike të brendshme dhe për konsum të brendshëm politik, sepse Kosova nuk mund ta diktojë orientimin e përgjithshëm të politikës së jashtme amerikane.

E dyta, Kosova nuk mund të ndikojë fare në interpretimin e të drejtës ndërkombëtare publike", theksoi Hasani.

Ish-ambasadori i Kosovës në Turqi, Avni Spahiu, duke folur për Radion Evropa e Lirë, vlerëson se reagimet lidhur me atë se Kosova mund ta hapë përfaqësinë e saj diplomatike në Jerusalem, mund të vazhdojnë edhe më tej. Por, sipas tij, Kosova duhet ta ndjekë shembullin e partnerit të saj strategjik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ndërkaq të punojë që partneriteti i Kosovës me Turqinë të mos dobësohet. Megjithatë, në rast se Kosova vendos ambasadën e saj në Jerusalem, sipas Spahiut, raportet me Turqinë do të ftohen. "Mendoj që do të ketë një farë lloj ftohjeje të raporteve dhe është detyrë e diplomacisë së Kosovës që të shpjegojë këtë qëndrim të palës së Kosovës, duke ditur që zotimi që kemi bërë në Uashington, duhet përmbushur dhe se njohja me Izraelin është shumë e rëndësishme për Kosovën. Në këtë mënyrë duhet të përpiqemi që të pengojmë një reagim që do të kishte pasojë të tepërta midis dy vendeve", ka theksuar Spahiu.

Ai shtoi se në rast se Kosova vendos ambasadën në Jerusalem do të ketë reagime edhe nga shtetet nga bota islame dhe nga Konferenca Islamike por, sipas tij, reagimet e tilla më shumë do të jenë në aspektin e qortimit për një veprim të tillë sesa që do të ketë veprime konkrete kundër shtetit të Kosovës.



Evazoni fiskal, deri në 30 për qind

Prishtinë, 1 mars - Nga mbi 200 mijë biznese sa janë të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, sipas Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), vetëm rreth 35 mijë prej tyre janë të fiskalizuara. Bazuar në këto të dhëna, shumë biznese vazhdojnë t'u ikën obligimeve tatimore që kanë ndaj shtetit. Pajisja me arka fiskale apo fiskalizimi i subjekteve afariste kishte filluar si proces në vitin 2010 dhe qëllimi ishte evitimi i evazionit fiskal, pasi potenciali i këtij sistemi është që t'i regjistrojë të gjitha hyrjet dhe daljet (shitjet). Në një përgjigje me shkrim nga ATK-ja dhënë për "Radion Evropa e Lirë", thuhet se numri i saktë i bizneseve të pafiskalizuara nuk mund të dihet. Aty shtohet se shumë faktorë afektojnë procesin e fiskalizimit sa iu përket statistikave. "Një numër i bizneseve nuk janë të obliguara që të fiskalizohen për shkak të natyrës së punës që zhvillojnë.

Bizneset që nuk janë të obliguara të pajisen me arka fiskale janë ato të cilat të gjitha pagesat i kryejnë përmes transaksioneve bankare, sektori bankar, bizneset mikrofinanciare si dhe disa nga ndërmarrjet publike", thuhet në përgjigjen e ATK-së. Përveç këtyre bizneseve që nuk janë të obliguara të pajisen me arka fiskale, ka edhe biznese të cilat regjistrohen, mirëpo asnjëherë nuk zhvillojnë aktivitet ose mbyllën menjëherë pas regjistrimit.

Administrata Tatimore e Kosovës në deklarimet e mëhershme për "Rel" ka potencuar se evazion fiskal ka në të gjitha anët e Kosovës, porse mendohet se ky aktivitet është i shtrirë më së shumti në katër komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe.

Konkurrencë e padrejtë në treg

Në ATK thonë se ekonomia joformale në Kosovë nga

mekanizmat ndërkombëtarë është vlerësuar të jetë deri në 30 për qind të Bruto Produktit Vendor, por sipas këtij institucioni, kjo shifër nuk implikon vetëm ATK-në. "Kjo shifër implikon një numër të madh të institucioneve për luftimin e evazionit fiskal, jo vetëm ATK-në, pasi raportet janë të ndërtuara duke pasur për bazë krimet ekonomike, kontrabandën, shpëlarjen e parave e shumë të tjera, përderisa ATK-ja ka përgjegjësi vetëm për pjesën e ekonomisë së hirtë", thuhet në përgjigjen e ATK-së. Sidoqoftë, numri i këtyre bizneseve të cilat iu shmangen obligimeve tatimore duke krijuar evazion fiskal, krijojnë konkurrencë të padrejtë në treg që, sipas pronarit të kompanisë "Frutex", Shaqir Palushi, paraqet një problem për bizneset formale.

Ai në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" thotë se për vite, si biznes që paguan të gjitha obligimet tatimore, janë përballur me një konkurrencë

të padrejtë në treg. "Prania e evazionit fiskal për vite në Kosovë sigurisht që ka dëmtuar biznesin, por në radhë të parë ka dëmtuar buxhetin e shtetit dhe rrjedhimisht qytetarët dhe zhvillimin e vendit. Ikja nga tatimi atyre bizneseve iu jep mundësi që të ofrojnë produkte me çmime më të ulëta dhe kjo për një biznes formal është konkurrencë e padrejtë", thotë ai.

Luftimi i evazionit fiskal rrit buxhetin e shtetit

Luftimi i evazionit fiskal është parë si mundësi për zhvillimin ekonomik të vendit. Në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", Arian Zeka, drejtor ekzekutiv në Odën Ekonomike Amerikane, thotë se për t'i realizuar premtimet për punësim e zhvillim ekonomik që ka bërë partia Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka fituar zgjedhjet e 14 shkurtit, duhet të luftohet ekonomia joformale.

"Me një qasje më serioze nga ana e institucioneve të shtetit, në rend të parë të ATK-së e cila bën mbledhjen e brendshme të tatimeve, mund të kemi rezultate të konsiderueshme në luftimin e ekonomisë joformale", ka thënë Zeka. Me qëllim të luftimit të evazionit fiskal, në vitin 2015 kishte hyrë në fuqi një udhëzim administrativ i cili parashihte që për të gjithë konsumatorët, të cilët grumbullojnë kuponët fiskalë dhe, si të tillë, i dërgojnë në ATK, do të aplikohet rimbursimi i vlerës së tatueshme të të gjithë kuponëve fiskalë në muajin pasues të çdo tremujori. Më pas ky proces kishte pësuar modifikime në rimbursim. Ndërkaq, në vitin 2020 ishte pezulluar me një vendim të ATK-së. Sipas ATK-së, për riaktivizimin e kampanjës "Rimbursimi i qytetarëve nga grumbullimi i kuponëve fiskalë", qytetarët do të informohen me kohë.

Drejtorët e kompanive për menaxhimin e mbeturinave kërkojnë mbështetje financiare

PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Ministri në detyrë i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesit e Shoqatës së Mbeturinave PAMKOS, drejtorin e kompanisë për

Menaxhimin e Mbeturinave dhe drejtorët e kompanive rajonale për menaxhimin e mbeturinave.

Gjatë takimit ministri Nitaj është njoftuar për sfidat e tyre, problemet dhe synimet për

avancimin e sistemit të pastrimit e trajtimit të mbeturinave.

Drejtorët e kompanive të mbeturinave po ashtu folën edhe për problemet me të cilat po përballen, veçmas me borxhet që kanë dhe në këtë

drejtim kërkuar mbështetje financiare. Po ashtu, drejtuesit e kompanive shprehen pakënaqësinë e tyre me trajtimin që u është bërë punëtorëve të këtyre kompanive nga pakoja e rimëkëmbjes ekonomike.



Fillon procesi i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Në pajtim me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave, ka filluar procesi i deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, ku të gjithë zyrtarët e lartë publikë janë të obliguar ta bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit. "Me qëllim të zbatimit të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/51, për respektimin e masave të përgjithshme dhe specifike nga pandemia Covid-19, rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, deklarimi i rregullt vjetor i pasurisë do të bëhet nëpërmjet formës elektronike në e-mail adresën akk.deklarimi@rks-gov.net, ndërsa formularët e deklarimit të pasurisë duhet të dërgohen të nënshkruar dhe skanuar nga ana

e subjekteve deklaruese", ka njoftuar AKK-ja. Agjencia Kundër Korrupsionit ka dërguar njoftimin të të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës (zyrtarët kontaktues për deklarimin e pasurisë) që ta bëjnë deklarimin e pasurisë sipas afateve kohore të përcaktuara me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave nga data 1 deri më 31 mars 2020. Në njoftimin e dërguar në institucionet publike, Agjencia Kundër Korrupsionit ka rikujtuar, gjithashtu, se mosdeklarimi i rregullt i pasurisë nga zyrtarët publikë dhe mosrespektimi i Ligjit nr. 04/L-050, si dhe Ligjit nr. 04/L-228 për deklarimin e pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë, Agjencia Kundër Korrupsionit do të paraqesë kallëzim penal në pajtim me nenin 437 të Kodit Penal.



Turqia shënoi rritje ekonomike prej 1.8-përqindësh në vitin 2020



ANKARA, 1 MARS - Instituti Turk i Statistikave (TurkStat) ka njoftuar se ekonomia e Turqisë është rritur për 1.8 për qind në vitin 2020, në vitin që u përshkua nga pasojat ekonomike të

pandemisë Covid-19. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) i Turqisë me çmimet aktuale ishte rreth 717.1 miliardë dollarë. Në tremujorin e fundit të vitit 2020, ekonomia turke shënoi një

normë të rritjes vjetore prej 5.9-përqindësh. Parashikimi i ekonomistëve për tremujorin e fundit të vitit të kaluar ishte mesatarisht 7 për qind, ku parashikimi më i ulët ishte 5 për

qind dhe më i larti 8.3 për qind. Ekonomia turke regjistroi një rritje prej 6.3-përqindësh në tremujorin e tretë të vitit të kaluar, pas rënies ekonomike prej 10.3-përqindësh në tremujorin e dytë,

kur ndikimi i pandemisë filloi të ndihej seriozisht. Në tremujorin e parë, PBB e Turqisë u rrit për 4.5 për qind. Në vitin 2019, shkalla e rritjes së vendit ishte 0.9 për qind.

Rriten rastet e të infektuarve me Covid-19 në Gjilan

GJILAN, 1 MARS (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, nën udhëheqjen e nënkryetarit të Gjilanit, Arbër Ismajli, ka mbajtur takimin për vlerësimin e situatës për dy ditët e fundit. Ismajli ka thënë se ka një rritje të infeksionit me Covid në Gjilan ditët e fundit, duke shtuar se kjo dëshmon që virusi është i pranishëm në mesin tonë. "Kemi një rritje të

ndjeshme të rasteve të reja pozitive dhe kjo dëshmon se virusi është në mesin tonë. Andaj, u bëj thirrje qytetarëve dhe bizneseve që japin shërbime, të vazhdojnë t'i respektojnë masat", ka thënë Ismajli.

Pasqyra e përgjithshme në Gjilan që prej fillimit të pandemisë është si vijon: nga 12 479 mostra, 3 773 kanë rezultuar pozitivë, 3 464 janë shëruar, 111 qytetarë e kanë

humbur betejën me virusin, 200 raste janë aktive, të hospitalizuar me Covid janë 28 persona.

Në këtë takim u bë me dije se është shqetësues fenomeni i ditëve të fundit i ndezjes së maleve në Gjilan, kurse u është bërë thirrje qytetarëve të mos vazhdojnë me kësi akte të shëmtuara, përndryshe sapa të identifikohen do të ballafaqohen me organet e drejtësisë.



Përfundojnë renovimet e sallës së edukatës fizike në shkollën "Zenel Hajdini" në kryeqytet

PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se kanë përfunduar renovimet e sallës së edukatës fizike në ShFMU "Zenel Hajdini". Ai ka thënë se tashmë me këtë renovim shkolla ka marrë një pamje tjetër dhe atmosferë pozitive për nxënësit. "Kanë përfunduar renovimet e sallës së edukatës fizike dhe pjesëve përcjellëse të saj (zhveshtoret). Është shtuar një aneks i ri ku shfrytëzohet si sallë e ping pongut, gjithashtu edhe renovimi i klasave dhe rregullimi i ngrohjes qendrore në



ShFMU "Zenel Hajdini". Drejtoresha për Arsim, Shpresa Shala, vizitoi dhe inspektoi punimet e shkollës ku tashmë me këtë renovim

shkolla ka marrë një pamje tjetër dhe atmosferë pozitive për nxënësit tanë", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

101 raste aktive me Covid në Deçan

Deçan, 1 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka mbajtur takimin konsultativ të këshillit të drejtorëve, ku është diskutuar për çështje të ndryshme. Gjatë takimit është diskutuar për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal të Deçanit, menaxhimin e situatës me

Covid-19, ku deri më 28 shkurt janë të identifikuar 757 raste me virusin Covid. Prej tyre 634 të shëruar, 22 kanë humbur jetën dhe 101 raste janë ende aktive. Po gjatë këtij takimi është diskutuar lidhur me projektet që do të realizohen në Komunën e Deçanit si dhe për aktivitetet e prokurimit.



Gjini nënshkruan marrëveshje partneriteti me OJQ "Roma Versitas Kosovo"

GJAKOVË, 1 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka nënshkruar të hënën marrëveshje partneriteti me OJQ "Roma Versitas Kosovo". Kjo marrëveshje parasheh që t'i zhvillojë aktivitetet e projektit: "Edukimi, punësimi, partneriteti dhe barazia gjinore: Formula e suksesit për romët në VET".

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Drejtoria e Arsimit dhe ajo e Zhvillimit

Ekonomik do të jenë pjesë e aktiviteteve që zhvillon "Roma Versitas Kosovo" për implementimin e të gjitha planeve aksionale të projektit e që janë bursat për nxënësit e shkollave dhe zhvillimi i praktikave profesionale.

Kjo marrëveshje nënshkruhet në Ditën Ndërkombëtare të Diskriminimit Zero për të shprehur qartë që në këtë botë të gjithë jemi të ndryshëm por, të barabartë.



Marrëveshje bashkëpunimi në mes të Komunës së Lipjanit dhe IADK-së

LIPJAN, 1 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, së bashku me drejtorin e Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK), kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për bashkëfinancimin dhe zbatimin e projektit "Fuqizimi i të rinjve dhe grave të zonave rurale për përfshirje në

bujqësi dhe përpunim të ushqimit". Nga projekti i cili do të implementohet në vitin 2021, në bazë kësaj marrëveshje do të organizohen trajnime për gra dhe të rinj të Komunës së Lipjanit, ku kandidatët më të suksesshëm do të përkrahen me mjete financiare për konkretizimin e ideve të tyre.

Të gjitha “shtetet” e vetëshpallura shqiptare

Nga: Bajram MJEKU

1.

Nëntë vjet pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe të nxitur nga serbët, më 17 korrik të vitit 1921, Zyra jugosllave për Shtyp në Prizren, njoftoi krijimin e të ashtuquajturës Republikë e Mirditës. Shef i saj u zgjodh kapidan Marka Gjoni. Serbët zgjodhën mirditorët për të realizuar ëndrrën e vjetër, daljen në Adriatik. E bënë edhe për të dhunuar shtetin shqiptar në sy të Evropës. Akti që i turpshëm. Ndodhi një vit mbas Kongresit të Lushnjës, kur fisnikët shqiptarë vendosën që shteti i ri të dilte nga koma. Këtë vit Nikolla Pashiq u zgjodh kryeministër i Jugosllavisë së Versajës. Pashiqi i kushtonte kujdes të veçantë përzgjedhjes së ambasadorëve serbë në shtetin shqiptar. Këshillonte ambasadorët e akredituar në Tiranë, që të informohej me urgjencë edhe për detajet më periferike që ndodhnin në Shqipëri. “Republika e Mirditës” që ideuar ekskluzivisht nga ai dhe akademikët serbë të kohës. Midis tyre ishte edhe shkrimtari shovinist serb, Ivo Andriq. “Derisa Konferenca e Ambasadorëve po zgjidhte çështjen e kufijve të Shqipërisë dhe organizimin e pavarësisë, në gjysmën e vitit 1921, me bajraktarët e Mirditës nënshkruam marrëveshje bashkëpunimi. Ishte paraparë formimi i shtetit të lirë të Mirditës, të cilin do ta mbronin forcat tona ushtarake. I ndjeri Pashiq duke udhëzuar përfaqësuesit tonë për punët në Shqipëri u thoshte: ‘Duan një Shqipëri të dobët dhe gjithmonë të trazuar’, shkruante në Elaboratin e tij për shfarosjen e shqiptarëve, shkrimtari shovinist serb, Ivo Andriq.

E ashtuquajtura Republikë e Mirditës, nuk mbijetoi më shumë se gjashtë muaj. Qeveria shqiptare mori veten. Zgjodhi Ahmet Zogun, komandant të operacioneve ushtarake për krahun lindor dhe Bajram Currin, komandant për krahun perëndimor. Me një ushtri të vogël bëri mrekulli dhe preu avancimin e serbëve drejt territorit shqiptar. Më 14 dhjetor, Zogu i dha fund grushtshtetit dhe u kthye gjithë triumf në Tiranë. Ishte çasti vendimtar kur djali i vendosur i Matit nisi të ngjitej në karrierë. Dhjetë ditë më vonë u zgjodh Ministër i Brendshëm. Një vit më pas Kryeministër. Tre vjet



më vonë President i Republikës dhe mbas tre vjetësh Mbret i Shqipërisë.

2.

Për dallim nga aventurat në Shqipëri, aventura të këtilla pati edhe në Kosovë. Shefat e këtyre “shteteve”, nuk kishin ide të zgjerimit nacional. I pari u shpall në dhjetor të vitit 1921. Quhej Zona Neutrale e Junikut. U themelua nga autoriteti i Lidhjes së Kombeve, për shkak të konflikteve të armatosura midis komitëve shqiptarë dhe ushtrisë jugosllave. Zona shtrihej përgjatë kufirit me Shqipërinë. Politika e elementëve të spikatur kosovarë, e cila ishte lidhur me Komitetin për Çlirim të Kosovës në vitet 1920-’24 ishte e gabuar. Në vend që udhëheqja e Komitetit të krijonte marrëdhënie me shtetin shqiptar, priu drejt konflikteve të vogla.

“Pas disa dështimeve politike dhe të armatosura në dhjetor të vitit 1921 dhe në rebelimin e marsit të vitit 1922, Hasan Prishtina një kundërshtar i vendosur i Ahmet Zogut, mendoj se ishte rasti të hakmerrej kundër tij duke përdorur Zonën Neutrale të Junikut. Në luftë të armatosur midis njerëzve të Ahmet Zogut dhe Hasan Prishtinës u vra Beqir Vokshi, nipi i njërit nga udhëheqësit kryesor të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Sulejman Vokshi, në janar të vitit 1923. Vrasja e Beqir Vokshit ishte vrasje e pastër politike dhe veçse e dëmtoi rëndë çështjen kombëtare. Kjo vrasje

përveç që solli elemente të reja të përçarjeve, ndihmoi së tepërmi suprimimin e Zonës Neutrale të Junikut, e cila mund të përdorej në dobi të çështjes kombëtare për të organizuar një lëvizje nacionalçlirimtare në Kosovë”, thotë historiani Kastriot Dervishi.

“Nji telegraf i fortë prej djelmënisë së Kosovës, thotë se i përmenduni patriot Beqir Vokshi, ra dëshmor nga plumbat e çetës së Hasan Prishtinës. Ky lajm i zi vërtetohet edhe nga telegrafet që kan marrë Ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo e Luftës prej autoriteteve kompetente të Prefekturës së Kosovës. Vrasja ka një randësi të posaçme e ata që njofin mirë Kosovën, kanë për t’u çuditë prej këtij guximi të kobshëm e tradhtar kaq të randë që muji m’u krye pej dorës së Hasan Prishtinës”, shkruante më 31 janar të vitit 1923, gazeta “Populli”, e cila drejtohej nga Bedri Pejani.

Zona Neutrale u përdor si strehë për kryengritësit. Për fat të keq u përdor edhe kundër shtetit të dobët shqiptar. Jo rrallë ndodhën sulme duke i djegur godinat qeveritare të Shqipërisë. Në mesin e kryengritësve që kishin synime të fisme, u infilturuan edhe mercenarë.

Zona Neutrale e Junikut nuk mund të jetonte gjatë. Kufijtë e Shqipërisë përfunduan në vitin 1926 me Traktatin e Firences. Disa historianë të prirë nga cene të mëdha, provuan të ngulitnin idenë se ishte ambasadori shqiptar në

Beograd, Ceno Bej Kryeziu i cili nënshkruajti aktin për mbetjen e Zonës Neutrale nën Jugosllavinë e Versajës. Ambasadori nuk kishte kompetenca për të nënshkruar akte të këtilla në emër të shtetit shqiptar. Zona Neutrale u shua në janar të vitit 1923.

3.

Në një Simpozium shkencor i organizuar nga Instituti Albanologjik në tetor të vitit 2014 në Prishtinë, një historian i ri i etur për nam, “mahnitë” të pranishmit. Tha se “me të mbaruar Lufta e Parë Botërore në fillim të vitit 1918, ndodhi rishpallja e pavarësisë së Shqipërisë në qytetin jugperëndimor të Kosovës, në Gjakovë”. Sipas tij, Gjakova ishte thënë të jetë kryeqytet i Shqipërisë së rishpallur. “Në dokumentet arkivore britanike flitet se në fillim të vitit 1918 në qytetin e Gjakovës me mbështetjen e Fuqive Qendrore, në rend të parë të Perandorisë Austro-Hungareze, u bë shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë”. Kur autori i këtyre radhëve e pyeti kush ishin personalitetet që rishpallën shtetin shqiptar në Gjakovë dhe a ekzistojnë dokumente që dëshmojnë këtë ngjarje?, historiani i ri u përgjigj: “Kush dëshiron të dijë më shumë, le të hulumtojë në Arkivin e Vjenës!”.

Shteti tjetër quhej Arbania e Vogël. U themelua nga kryengritësi shqiptar, Azem Galica, në verën e vitit 1923 në Drenicë. Edhe Galica me besnikët e tij qëndroi një kohë

në Zonën Neutrale të Junikut. Duket që për themelimin e “shtetit” të tij mund të jetë inspiruar në Junik. Në kuadër të “shtetit” të ri funksionuan njëmbëdhjetë katunde të Drenicës. Para se të shuhej mbetjen tri. Shefi i Arbanisë së Vogël u zotua se shtetasit e tij nuk do t’i paguanin taksa Jugosllavisë së Versajës dhe nuk do t’i përgjigjeshin thirrjeve për shërbim ushtarak. Sipas marrëveshjes, shtetasit e tij u zotuan t’i përgjigjen vetëm thirrjeve të Azem Galicës sa herë shfaqej nevoja. Kryengritësi shqiptar ngriti një kullë në vendlindjen e tij në Galicë, që ishte një lloj pallati rezidencial.

Një tjetër “shtet” u shpall menjëherë mbas Luftës së Dytë Botërore. Ndodhi në Marec të Gollakut, dhjetë milje larg kryeqytetit të Kosovës. Shef u vetëshpall Shtet Mareci, një luftëtar i kësaj ane, i cili kishte luftuar kundër serbëve. I përkiste krahut ushtarak të Lëvizjes Nacionaldemokratike Shqiptare. Diskursi i tij politik ishte i njëjtë me Lëvizjen politike që i takonte; për Shqipërinë etnike. Kur nuk u realizua ëndrra e tij, Shteti u barrikadua në vendlindjen e tij në Marec, njëri nga fshatrat më të mëdha në Kosovë dhe kontrollloi këtë zonë deri në shkurt të vitit 1947. Pas një lufte të pabarabartë disaorëshe me partizanët serbë në Meshinë të Kamenicës nuk u dorëzua i gjallë. Në duart e tij plasi dy bomba dhe vdeken e zgjodhi në mënyrë epike.

/Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Feronikeli shijon fitoren e parë në pranverë, Gjilani regjistron tjetër barazim

Feronikeli ka marrë tri pikë nga përballja me Arbërinë dhe kjo ishte fitorja e parë në katër ndeshjet e fazës së tretë në Superligë. Ndryshe nga "Nikli", Gjilani ende nuk ka shijuar fitore në këtë fazë, pasi ka mbetur baras të hënën me Drenicën

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 1 mars - Java e 22-të në Superligën e Kosovës në futboll ka përfunduar me dy ndeshjet që janë zhvilluar të hënën. Feronikeli e ka shijuar fitoren e parë në sezonin pranveror apo në fazën e tretë të kampionatit 2020/2021, pasi e ka mposhtur Arbërinë me rezultat 0-3. Trajneri i Feronikelit, Klodian Duro, ka deklaruar: "Ne jemi një ekip i bashkuar dhe secili bën detyrat e veta. Mendoj se këtë fitore dua t'ua dedikoj futbollistëve të mi që japin gjithçka për fanellën". Vendësit janë mbajtur vetëm deri në minutën e 39, kur Argjend Malaj me kokë realizoi golin e parë për "Niklin", kurse në fund të pjesës së parë Mendurim Hoti realizoi për 0-2. Në minutën e 77-t Damir Kojaseviq realizoi golin e tretë dhe të fundit në ndeshje. Arbëria pati disa raste shënimi, por nuk arriti ta shënojë as golin e nderit. Pas tri pikëve të fituara në këtë ndeshje, Feronikeli ngjitet në pozitën e gjashtë me 27 pikë, kurse Arbëria mbetet në kuotën e 25 pikëve dhe zë vendin e tetë në elitë. "Futbollit luhet për ta kaluar topi vijën fatale, tek ne dhe rastet e qindpërqindta nuk po realizohen. Rastet nuk t'i sjellin pikët, por golat. Djemtë u angazhuan dhe luftuan, por gabimet që po përsëriten po ndikojnë në moralin e ekipit", ka thënë pas ndeshjes Arbnor Morina, trajner i Arbërisë.

Pjesa e parë e ndeshjes ishte mjaft dinamike, fillimisht rrezikuan mysafirët me anë të Qëndrim Dautajt dhe Ardit Hilës, por pa pasur gol të shënuar. Vendësit u kundërpërgjigjën dy herë me Ukën dhe Zabergjën, por ishte portieri Koliqi që e shpëtoi Gjilaniin pa pësuar gol. Në pesë minuat e parë të pjesës së dytë Darko Nikaç pati dy raste që nuk i finalizoi në gol,



ndërsa nën anën tjetër rastet nuk i shfrytëzoi as Kreshnik Uka për Drenicën. Ndeshja u mbyll me rezultat 0-0, kurse tash Drenica është në kuotën e 24 pikëve dhe renditet e parafundit në tabelë, ndërsa Gjilani mban pozitën e katërt me 32 pikë. "Është e vërtetë që kanë munguar katër ose pesë futbollistë, por kjo nuk arsyetohet. Mendoj se ekipi duhet të luajë më guximshëm. Djemtë dhanë maksimumin. I përgëzoj për angazhimin e tyre, por në këtë angazhim duhet të ketë më shumë këmbëngulësi, vetëbesim, gjakftohtësi, siguri, dhe këto sot na munguan. Jam i kënaqur me këtë rezultat, por kjo skuadër jam i sigurt se mund të jap më shumë. Prandaj duhet të korrigjohen gabimet, duhet shumë punë në aspektin e krijimit të vetëbesimit", ka thënë pas ndeshjes Bylbyl Sokoli, trajner i Gjilaniit.

Nga skuadra e Drenicës nuk ka pasur prononcim për media as pas kësaj ndeshjeje. Në këtë xhiro, Drita e mposhti Besën e Pejës dhe e mori

kryesimin në Superligë. Ballkani u mposhtë nga Llapi dhe tash pozicionohet në vendin e dytë, kurse Prishtina mori tri pikë të rëndësishme në Mitrovicë dhe u është afruar dy skuadrave ta para në tabelë, duke bërë që gara për titull të bëhet edhe më interesante.

SUPERLIGA - Java 22		
Arbëria - Feronikeli		0-3
Drenica - Gjilani		0-0
Llapi - Ballkani		1-0
Drita - Besa		3-1
Trepça '89 - Prishtina		1-2
Tabela		
1. Drita	22	47 pikë
2. Ballkani	22	45
3. Prishtina	22	44
4. Gjilani	22	32
5. Trepça '89	22	28
6. Feronikeli	22	27
7. Llapi	22	26
8. Arbëria	22	25
9. Drenica	22	24
10. Besa	22	7
Në xhiron e radhës takohen: Gjilani-Arbëria, Feronikeli-Drita, Ballkani-Drenica, Besa-Trepça '89, Prishtina-Llapi.		

SHKURT

Toutzaiarkis shpallet MVP i javës 21

Takimet në fundjavë kanë dhuruar ndeshje mjaft interesante në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Qendra e Trepçës, Stavros Toutzaiarkis, kishte indeksin më të lartë në xhiron e fundit, 40. Ai në përballje me Ponte Prizrenin, sfidë që shkoi në dy vazhdimë, realizoi 30 pikë dhe kishte 22 kërcime, 11 në mbrojtje dhe 11 dhe në sulm. Gjithashtu, Stavros Toutzaiarkis kontribuoi me tri asistime, një top të vjedhur dhe dy bllokada, duke qenë lojtari më i dalluar në parket dhe duke ndihmuar Trepçën ta shënojë fitoren e katërt radhazi. Mitrovicasit renditen në vendin e gjashtë me tetë fitore dhe 13 humbje. Ndërkohë, top pesë basketbollistët me indeksin më të lartë në xhiron e fundit janë: Stavros Toutzaiarkis (Trepça) 40, Nigel Johnson (Sgjal Prishtina) 38, Divine Myles (Ponte Prizreni) 36, Ivan Koljeviq 29 (Trepça), Brandon Walters 28 (Peja).

Rashica në formacionin e javës në Bundesliga

Ylli i Werder Bremenit dhe Përfaqësueses së Kosovës, Milot Rashica, vazhdon shkëlqimin në Bundesliga. Faqja e Bundesligës ka publikuar edhe formacionin më të mirë të javës, ku bëjnë pjesë tre yje të Bayernit. Bashkë me Lewandowskin, Gortzekan dhe Sulen, në këtë formacion figuron edhe emri i sulmuesit nga Vushtrria. Formacioni: Gikiewicz, Sule, Gouweleuw, Lacroix, Otavio, Bailey, Endo, Goretzka, Sosa, Lewandowski, Rashica.

Xhaka: Duhet të fitojmë çdo ndeshje

Arsenali e mposhti Leicester Cityn (1-3) në ndeshjen që u zhvillua të dielën në "King Power Stadium". Mesfushori Granit Xhaka ka deklaruar se Arsenali ka potencial për t'u ngritur në renditjen tabelore, por për të arritur një gjë të tillë duhet të fitohet ndeshje pas ndeshjes. "Duhet të fitojmë ndeshje pas ndeshje, jo vetëm për tre ndeshje, jo për katër, por duhet ta bëjmë vazhdimisht. Dhe me këtë energji, me këtë shpirt skuadre, atëherë do të mund të bënim diçka. E dinim që do të kishim të vështirë pas Ligës së Evropës, pas udhëtimeve dhe gjithçka tjetër. Ishin pikë të rëndësishme për ne", ka deklaruar Xhaka.

PSG-ja largon Icardin, merr Agueron

Kriza e madhe financiare e pësuar nga Covid-19 ka goditur edhe financat e shëndosha të PSG-së. Leonardo po kërkon që t'i japë zgjidhje situatës për ta larguar Mauro Icardin që i kushton një shifër të majme monetare. Në këtë drejtim PSG-ja do të fitonte shumë edhe për ta rinovuar kontratën me yllin e saj, Mbappen. Ndërkohë për ta zëvendësuar Icardin pritet të vijë Agueron, i cili është në skadim të kontratës me Manchester Cityn dhe do të vinte me parametra zero.

Sot përballen skuadrat prizrenase

PRISHTINË, 1 MARS - Në mesjavë do të zhvillohen ndeshjet e mbetura të xhiros së 20 në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Sot (e martë) do të përballen skuadrat prizrenase, Ponte Prizreni me Bashkimin. Ponte

Prizreni ka 13 fitore dhe shtatë humbje, ndërsa Bashkimi 10 fitore dhe 10 humbje. Takimet në mes të skuadrave prizrenase kanë qenë interesante dhe kështu pritet të jetë edhe të martën mbrëma. Ndërkohë,

nesër (e mërkurë) do të përballen skuadrat verdhezi, Peja dhe Golden Eagle Ylli. Pejanët kanë 12 fitore dhe tetë humbje, ndërsa therandasi 13 fitore dhe shtatë humbje. Të dyja ndeshjet zhvillohen nga ora 19:00.



Policia bastis zyrat e Barcelonës, arrestohet Bartomeu

BARCELONË, 1 MARS - Josep Maria Bartomeu është arrestuar nga policia spanjolle për përfshirjen në skandalin e fushatës së 'Barcagate' gjatë kohës sa ishte president i klubit. Bartomeu është një nga tre personat që

janë arrestuar deri më tani, me CEO të Barcelonës Oscar Grau dhe shefin e shërbimeve juridike Roman Gomez Ponti dy të tjerët. Të hënën në mëngjes policia ka hyrë në zyrat e Barcelonës, ka mbledhur prova dhe ka kryer

arrestimin. Kujtojmë se Bartomeu ishte një nga figurat i cili hyri në konflikt me Messin në lidhje me ekipin. Mediat spanjolle shkruajnë se operacioni ishte i lidhur me 'Barcagate' të vitit të kaluar, në të

cilin zyrtarët e klubit u akuzuan për fillimin e një fushate shpifësh kundër lojtarëve aktualë dhe ish-lojtarëve që ishin kritikë ndaj klubit dhe presidentit të atëhershëm Bartomeu.



Gjashtë fitore rresht për Miamin, Lakersat triumfojnë ndaj Warriorsit

MIAMI, 1 MARS - Miami Heat është një nga skuadrat më në formë për momentin në NBA. Nënkampionët e edicionit të kaluar koleksionuan fitoren e 6-të radhazi pasi mposhtën pa shumë vështirësi në "American Airlines Arena" Atlanta Hawksin me rezultatin 109-99. Një sukses ky që e ngjiti skuadrën nga Florida në vendin e 7-të në konferencën e Lindjes me 17 fitore dhe 17 humbje. 34 pikë dhe 10 rebounde të Collinsit, por edhe 20 pikë dhe 14 rikuperime poshtë tabelës të Clint Capela nuk i mjaftuan skuadrës nga Georgia, ndërkohë që për Miamin spikati Nunn me 24 pikë, ndërsa Adebayo shtoi 16 të tjera. Rigjen veten Los Angeles Lakers që mori fitoren e 2-të rresht pasi mposhti në Staples Center Golden State Warriorsin me rezultatin 117-91. Falë 19 pikëve të mbretit James, por edhe faktit që plot 6 basketbollistë të Lakersit, përfshirë edhe LeBron dhe gjermanin Denis Schroder, arritën një kuotë pikësh me dy shifra, bënë të mos ndihej mungesa e Anthony Davisit. Kjo



ishte fitorja e 24-t sezonale për Lakersin që u ngjiten sërish në vendin e 2-të në Konferencën e Perëndimit duke parakaluar Los Angeles Clippersin. Vijon momenti pozitiv për Boston Celticsin që mori fitoren e 3-të rresht falë suksesit minimal 111-110 ndaj Washington Wizardsit. Një sukses i arritur në limite nga Celticsi që iu falë edhe formës së mirë të treguar nga dyshja Jason Tatum-Kemba Walker. Washington në krahun tjetër vazhdon të ketë shumë luhatje

teksa këtë herë nuk i mjaftuan as plot 70 pikë të realizuara nga dyshja Bradley Beal-Russell Westbrook. Largimi i James Hardenit për te Brooklyn Netsi në fillim të këtij sezoni, ka lënë një gropë aq të madhe te Houston Rocketsi sa që skuadra teksane po turpërohet gjithnjë e më shumë në këtë sezon të NBA-së. Humbja e 11-të radhazi e pësuar në Toyota Center me plot 49 pikë disavantazh nga Memphis Grizzlies tregoi se sa dobët është Houstoni në këtë sezon.

Drejtuesit e FFK-së takohen me përzgjedhësin Nees

PRISHTINË, 1 MARS - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, kanë zhvilluar sot takim me përzgjedhësin e Përfaqësueses U21, Michael Nees. Gjatë këtij takimi u bashkëbisedua rreth përgatitjeve të Përfaqësueses U21 për dy miqësoret e këtij muaji në Doha të Katarit. "Kryetari Ademi dhe sekretari i përgjithshëm Salihu i ofruan mbështetje maksimale përzgjedhësin Nees që, përkundër situatës së rëndë me pandeminë, të realizohen këto miqësore dhe ai t'i ketë në dispozicion të gjithë lojtarët që synon në grumbullimin e tij të parë si përzgjedhës i Përfaqësueses U21. Po ashtu, u diskutua edhe për stafin teknik të Përfaqësueses, i cili do të



kompletohet gjatë ditëve në vazhdim", thuhet në njoftimin e FFK-së. Përfaqësuesja U21 do të udhëtojë më 21 mars në Doha, derisa miqësoret do t'i zhvillojë më 26

dhe 29 mars. Ky grumbullim do të jetë një mundësi e mirë për përzgjedhësin Nees për ta përgatitur sa më mirë ekipin për ciklin e ri kualifikues që nis në qershor.

Dueli Fury - Joshua, afër zyrtarizimit

Anthony Joshua ka bërë si një konfirmim se përballja për titullin kampion të padiskutuar me Tyson Fury në peshat e rënda do të zhvillohet në muajin qershor. Dyshja ka kohë që janë në bisedime për të zhvilluar meçin më të mëdha në histori të boksit, aty ku në pyetje janë titujt si WBC,

WBA, WBO, IBF. Një datë zyrtare dhe vendi ku do të zhvillohet dueli ende nuk janë konfirmuar, mirëpo muaji qershor tashmë është i ditur. "Në qershor do të jetë data. Më besoni. Për fansat, për njerëzit që e kanë pritur me muaj me radhë. Thirrje edhe për Fury dhe ekipin e tij, gjithashtu, takime të uritura,

kjo është ajo që ne jemi", ka thënë Joshua. "Mbretëria e Bashkuar ngrihu në këmbë. Dhe në botë ne po e sjellim atë. Mezi po pres. E padiskutueshme", ka shtuar më tej ai. Duket se Fury do ta injorojë totalisht Deontay Wilderin për trilogjinë dhe do të ketë fokusin tek AJ.

SHKURT

Vdes legjenda e Kroacisë, Zlatko Kranjčar

Futbollisti dhe trajneri legjendar kroat i futbollit, Zlatko Cico Kranjčar, ka ndërruar jetë. Ai vdiq në KBC Merkur pas një sëmundjeje të shkurtër dhe të rëndë. Shëndeti i Zlatko Kranjčar u përkeqësua rreth dhjetë ditë më parë në Zadar, ku përfundoi në spital. Ai u transferua me urgjencë në Zagreb, por mjekët nuk ishin në gjendje t'ia shpëtonin jetën. Në karrierën e tij në futboll, Kranjčar ishte i njohur si një nga sulmuesit më të mirë të Dinamos së Zagrebit. Ai mori pjesë në kampionatin e famshëm jugosllav në vitin 1982, si dhe dy Kupa Marshall Tito më 1980 dhe 1983. Ai shënoi 98 gola për "Blutë" në 261 ndeshje. Luajti për Jugosllavinë 11 ndeshje dhe shënoi tri gola. Në karrierën e tij si trajner, ai udhëhoqi klube të shumta si dhe ekipin kombëtar kroat, me të cilin fitoi një vend në Kupën e Botës 2006 në Gjermani. Ai udhëhoqi Kroacinë nga korriku 2004 deri në gusht 2006. Në 25 paraqitje në stol, ai regjistroi 11 fitore, tetë barazime dhe gjashtë humbje.

Crotone shkarkon Stropan, Cosmi emërohet trajner i ri

Tashmë është zyrtarë, Giovanni Stroppa nuk është më trajner i Crotones. Ky shkarkim nga detyra e trajnerit vjen si pasojë e humbjes ndaj një kundërshtari direkt për mbijetesë si Cagliari që e mundi Crotonen me shifrat 0-2 në shtëpi, por edhe si pasojë edhe një serie të gjatë negative ku klubi i Crotones renditet i fundit me 12 pikë të grumbulluara në 24 javë në kampionatin italian. Ndërsa Serse Cosmi do të jetë trajner i ri i skuadrës Crotones.

Griezmanni do të shitet në verë

Barcelona po planifikon ta shesë gjatë verës sulmuesin Antoine Griezmann. Drejtuesit e skuadrës spanjolle nuk janë të kënaqur me paraqitjet e sulmuesit dhe dëshirojnë ta largojnë. Barcelona për ta liruar Griezmannin po kërkon mbi 50 milionë euro. Për sulmuesin 29-vjeçar interesim kanë shprehur Manchester Unitedi dhe PSG-ja. Griezmann në të gjitha garat këtë edicion ka shënuar 12 gola dhe ka bërë 10 asistime. Ai ka kontratë me klubin spanjoll deri në vitin 2024.

Ibra mungon kundër Unitedit

Sulmuesi i AC Milan, Zlatan Ibrahimović, ka pësuar një lëndim në ndeshjen ndaj Romës në kuadër të xhiros së 24-t të Serisë A. "Rossonerët" arritën një fitore tejet të rëndësishme ndaj Romës në "Stadio Olimpico". Por, pas fitores, në Milanello erdhi lajmi për një humbje tjetër. Bëhet fjalë për lëndimin e Zlatan Ibrahimovićit, i cili pësoi një lëndim ndaj Romës. Pas ekzaminimeve mjekësore të fundit, është konfirmuar se Ibra ka lënduar kofshën e majtë. Në raport bëhet me dije se edhe Hakan Calhanoglu ka pësuar një lëndim, ndërsa Ante Rebić është në gjendje të mirë. Suedezi do t'u nënshtrohet prapë ekzaminimeve mjekësore pas 10 ditësh, por kjo do të thotë që ai do ta humbë ndeshjen ndaj Manchester Unitedit në Ligën e Evropës.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
 FERIZAJ
 Nr. 26, Data 01.03.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS - REBUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.

Ndërmarrja Publike Lokale
"Stacioni i Autobusëve "Sh.A.
FERIZAJ

Kryeshefi Ekzekutiv i Stacioni Autobusëve Sh.a.Ferizaj në bazë të nenit 16 pika 1 të Statutit të kompanisë, Ligjit të Punës nr.03.L-212 neni 8 dhe 10 pika 2.2 Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Organogramin , lidhur me plotësimin e vendit të punës, shpallë:

KONKURS

ME KOHË TË CAKTUAR 1 VJET ME MUNDËSI VAZHDIMI

Për vendin e punës.(1) Biletar

Kualifikimet e nevojshme:

Kërkesën dhe CV

7. Shkolla e mesme
8. Aftësi për të punuar në mënyr të pavarur dhe si pjesë e ekipit
9. Shkathtësi të shkëlqyeshëm komunikuese
10. Shkathtësi të shkëlqyeshëm për kompjuter (Certifikatën nga ndonji institucion kredibil).
11. Përovja e punës është e dëshirueshme
12. Dëshmi se nuk është nën hetime

Vlerësimi dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim
Lartësia e pagës përcaktohet në harmoni me politikat e Kompanisë
Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionin në zyrë të kompanisë N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A në Ferizaj dhe po në të njëjtin vend edhe mund ti dorëzojnë aplikacionet.

Dokumentacioni i pa kompletuar nuk do të konsiderohet të vlefshëm.Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë, pas seleksionimit të dokumentacionit të paraqitur nga komisioni përkatës.

Afati për dorëzimin e aplikacionit është 8 ditë nga dita e publikimit të konkursit prej orës 8- 16 :00.

Ferizaj ,më 01.03.2021

N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A.
Kryeshefi Ekzekutiv
A. Qalaj
Albulenë Qalaj

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Safet Smajli shpall të pavlefshme dëftesat nga klasa e 5-te deri tek klasa e 9-te të shkollës fillore "Dëshmorët e Qyqavices" (Qirez-Skenderaj).
- ▶ Avdyll Sadik Hyseni shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore, të lëshuar nga ShFMU "Dëshmorët e Qyqavices" në Çirez.
- ▶ Adnan Bylybi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.
- ▶ Armend Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.
- ▶ Lirim Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Fadil Hisari" Prizren.
- ▶ Veton Dina shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

